Breaking News: Sarandë – I vodhën një pushueseje nga Greqia, çantën, ndalohen 2 shtetas nga Maqedonia e Veriut



Lajmet

*23/08/2024*

# Elbasan – Qarkullonte I Armatosur Me Pistoletë, Në Mesnatë, Në Lagjen "Luigj Gurakuqi", Arrestohet 26-Vjeçari

26-vjeçari  u konstatua me armë, nga një punonjës policie që ishte jashtë orarit të shërbimit.

Në momentin e konstatimit, shtetasi i armatosur ka kanosur punonjësin e Policisë, për ta vrarë.

Falë veprimeve profesionale të punonjësit të Policisë dhe mbërritjes në kohë të Patrullës së Përgjithshme dhe Forcës së Posaçme "Shqiponja", që ishin në patrullim në qytet, të cilat ishin njoftuar nga punonjësi i Policisë, është neutralizuar dhe arrestuar 26-vjeçari.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua arma e zjarrit pistoletë me municion luftarak.

Në përfundim të veprimeve të para procedurale u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit R. B., 26 vjeç, banues në Elbasan.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Kanosja për shkak të detyrës " dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit luftarak".

‹ Shkodër – Megaoperacioni "Territor i pastër", asgjësohen 1790 bimë dhe 86 fidanë cannabisi

Kavajë – Arrestohet autori i 3 vjedhjeve dhe i 1 tentative për vjedhje, të kryera dje dhe gjatë muajit korrik ›

## Kërko

Enter a word for search

## Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

## Arkiva

Select Month

## Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent

Copyright © 2024 Policia e Shtetit. All rights reserved. Theme: ColorNews by ThemeGrill. Powered by WordPress.